



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Projekti Original:

Projekti Nr. P121186; Huaja Nr. 8211-AL;

Financimi Shtese:

Projekti Nr. P162786; Huaja Nr. 8817 AL;

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

Për shërbimin e konsulencës individuale

“Konsulent i Prokurimeve”

(Nr. Referencës së Prokurimit WRIP/CS/IC/001)

Kjo kërkesë për shprehje interesi është vazhdim i Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, publikuar në faqen e Zhvillimit të Biznesit në 25 Maj, 2010; në Njoftimin e Përgjithshëm, përditësuar në 20 Dhjetor 2012, me referencë në Zhvillimin e Biznesit Nr. WB5260-12/12.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një kredi në shumën ekuivalente 31 milion Euro nga Banka Botërore, kundrejt kostos së Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes. Nje Financim Shtese ne Shumen 23 milion Euro eshte propozuar, gjithashtu, me qellim pershkallezimin e Projektit tashme te suksesshem dhe per te perfshire investime dhe aktivitete shtese. Qeveria e Shqipërisë synon të aplikojë pjesë të këtij fondi për pagesën e **“Konsulentit të Prokurimeve”** (me kohe të plote), pjese e Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT) ngritur në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Detyra parashikohet të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të perzgjedhjes.

✓ Objektivat e Detyrës

Projekti është plotësisht i integruar në funksionet e rregullta të disa drejtorive në MBZHR, si agjenci implementuese. Pavarësisht se MBZHR ka një Sektor Prokurimesh, pjesë e Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, për të kryer procedurat e prokurimeve, një Konsulent Prokurimi (me kohe të plote) me eksperiencë në projektet e financuara nga Banka Botërore ka qenë kontraktuar që në fazën përgaditore të Projektit për aspektet FIDIC të tij. Objektivi i këtij Shërbimi Konsulencë është të garantojë që: (i) prokurimet po kryhen në përputhje të plote me kërkesat e Bankës të vendosura në Udhëzuesit dhe Rregulloret e Bankës Botërore për prokurimet; (ii) ngritjen/fuqizimin e kapaciteteve në Sektorin e Prokurimeve në MBZHR; dhe (c) të ndihmojë në zbatimin e aktivitetëve të planifikuara brenda afateve.

Konsulenti i Prokurimeve do të asistojë Koordinatorin e Projektit dhe Menaxherin e Projektit, dhe do të punojë ngushtë me stafin e Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve/Sektorin e Prokurimeve në MBZHR për të menaxhuar ecurinë e aktivitetëve të prokurimeve të skeduluara për Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes.

✓ **Objektivi i punës**

Detyrat dhe Përgjegjësitë: Funkcionet kryesore të Specialistit të Prokurimeve do të përfshijnë si më poshtë:

- Prokurimi i mallrave, punimeve civile dhe shërbimeve në përputhje me dispozitat në Udhëzuesit dhe Rregulloret e Bankës Botërore për Prokurimet, Manualin Operacional të Projektit dhe Legjislacionin shqiptar;
- Koordinimi me stafin e Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore, Drejtorise se Pergjithshme te Politikave te Bujqesise, Sigurise Ushqimore dhe Zhvillimit Rural (Drejtoria e Programeve te Zhvillimit te Bujqesise, Sigurise Ushqimore dhe Zhvillimit Rural) me qëllim përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës për aktivitetet e planifikuara;
- Koordinimi me stafin e Drejtorise se Prokurimeve dhe Parteriteteve/Sektorin e Prokurimeve në mënyrë që dokumentet të firmosen në kohë dhe në përputhje me procedurat e rena dakort;
- Pjesëmarrje në përgatitjen dhe përditësimin periodik të planit të prokurimit të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, kryerja e verifikimeve dhe përditësimi i tij;
- Kryerja e procedurave të prokurimit bazuar në planin e prokurimit të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes;
- Mbajtja e sistemit të raportimit të prokurimeve në përputhje me parashikimet e Manualit Operacional të Projektit;
- Mbështetje e Koordinatorit të Projektit në përgjegjësitë e tij për monitorimin e zbatimit të kontratave;

Në përgjithësi, detyrat specifike që do të ndërmerren nga Konsulenti i Prokurimeve duhet të mbulojnë të gjitha metodat e prokurimit të përcaktuara në planin e prokurimit. Kjo do të përfshijë por nuk do të kufizohet në dhënien e ndihmesës praktike për:

- Përgatitjen dhe publikimin e Njoftimeve Specifike të Prokurimit sic aplikohen nën metodat e ndryshme të prokurimit dhe nën legjislacionin Shqiptar;
- Pjesëmarrja në komisionet e vlerësimit sipas termave të përshkruara në dispozitat për komisionin e vlerësimit në Manualin Operacional të Projektit;
- Përgatitja e Dokumentave të Tenderit, Kërkesës për Propozim dhe dokumentave të tjerë bazuar në Dokumentat Standarte të Tenderit/Dokumenteve Standarte të Prokurimit dhe formatet shembuj të aprovuara për projektin, dhe në procesin e përzgjedhjes, përfshirë këtu takimet para-ofertimit apo para-propozimit, sqarimet, hapjen e ofertave, etj;
- Mbështetje administrative dhe procedurale në vlerësimin Teknik dhe Financiar të ofertave dhe përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ofertave në përputhje me dispozitat e Manualit Operacional të Projektit;
- Mbështetje administrative dhe procedurale në vlerësimin e propozimeve Teknike dhe Financiare të konsulenteve dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit Teknik dhe Financiar në përputhje me dispozitat e Manualit Operacional të Projektit;
- Përgatitja e kontratave në përputhje me format e aprovuara për projektin;
- Negocimi i kontratës dhe firmosja
- Administrimi i përgjithshëm i kontratës dhe monitorimi;
- Verifikimi i dokumentacioneve të pagesës për kontratën e furnizimit të mallrave, punimeve civile dhe shërbimeve; dhe
- Procedurat e mbylljes së kontratës dhe raportimi përfundimtar.

✓ **Kërkesat për Kualifikim dhe Eksperienca**

- Personi i përshtatshëm për pozicionin e Konsulentit të Prokurimeve për Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes në MBZHR duhet të ketë kualifikimet në vijim:

- Diplome Master në Ekonomik, Juridik, Inxhinieri ose kualifikime profesionale ekuivalente të pershtateshme per kete detyre;
- Të paktën 3 vjet eksperincë në prokurimet e projekteve të financuara nga donatorët e huaj dhe fondet publike. Preferohen kandidatët, të cilët janë familjarë me Udhëzuesit dhe Rregulloret e Bankës Botërore per Prokurimet dhe Ligjin e Prokurimit Publik;
- Njohuri ne sistemin: “*Ndjekja Sistematike e Shkëmbimeve në Prokurim*” (STEP) dhe aftesi ne operimin e tij përbën nje avantazh;
- Njohuri në kompjuter me eksperience praktike të përdorimit të aplikacionit MS Office. Përdorimi i software-ve të tjerë përbën avantazh;
- Rrjedhshmëri në gjuhën Shqipe dhe gjuhën Angleze;

✓ **Afatet**

Pritet që Konsulenti i Prokurimeve do të fillojë punë menjehere dhe do te punoje me kohe te plote. Konsulenti i Prokurimeve do të raportojë tek dhe do të punojë nën drejtimin e Koordinatorit të Projektit dhe Menaxherit të Projektit në MBZHR. Ajo/Ai do të dorëzojë raporte progresive mujore dhe përditësimin e Planit të Prokurimit. Meqenese Konsulenti i Prokurimeve do të punoje ngushte me stafin e Drejtorine e Prokurimeve dhe Partneriteteve/Sektori i Prokurimeve brenda MBZHR. Ajo/Ai do te dorëzojë kopje të të gjithë raporteve edhe Drejtorit të Drejtorisë Prokurimeve dhe Partneriteteve.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) fton individë të kualifikuar të tregojnë interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin: (i) një letër motivimi, duke nënvizuar avantazhet e tyre lidhur me këtë pozicion, (ii) Curriculum Vitae si dhe (iii) informacion, që tregon që ata kanë kualifikimet e kërkuara për kryerjen e Shërbimeve të Konsulencës, dhe (iv) referenca të ndryshme. Te gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në gjuhën Angleze.

Kriteret e shortlistimit janë:

- | | |
|--|---------|
| 1. <i>Kualifikimet e Pergjithshme</i> | 30 pikë |
| - <i>Diplome Master sic kerkohet</i> | |
| - <i>Kualifikime dhe certifikata pas-universitare</i> | |
| 2. <i>Përshtatshmëria për detyrën</i> | 60 pikë |
| - <i>Eksperienca specifike ne prokurimin e projekteve te financuara nga donatore te huaj (Banka Boterore dhe te tjere)</i> | |
| 3. <i>Eksperienca Specifike</i> | 10 pikë |
| - <i>Eksperienca/Kontrata te ngjashme dhe njohuri te Ligjit te Prokurimit Publik</i> | |

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9 të *Udhëzuesit të Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën kreditë dhe Grantet e IBRD dhe IDA, botimi Janar 2011*, ku përcaktohet politika e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhja e **Konsulentit Individual (IC)**, në përputhje me procedurat për përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë të përcaktuara në *Udhëzuesin: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, botimi Janar 2011*.

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacion të mëtejshëm në lidhje me Termat e Referencës në faqen zyrtare të MBZHR: www.bujqesia.gov.al ose në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00 - 16:30 (E hënë – E enjte) dhe 08:00 - 14:00 të Premten:

Z. Ilirjan LAME
Menaxher Projekti

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 4 2226243 - 75129
e-mail: ilirjan.lame@bujqesia.gov.al

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen jo më vonë se data **21 Maj 2018**; të printuara (personalisht ose me postë) në adresën e mëposhtëme, brenda orarit zyrtar, dhe elektronikisht në adresën e e-mailit më sipër.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Zyra e Protokollit)
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Znj. Aurora ALIMADHI
Sekretar i Përgjithshëm